


Bibël për fëmijët paraqet



Parajsa, Shtëpia e Bukur e Perëndisë



Shkruar nga: Edward Hughes
Ilustruar nga: Lazarus
Adaptuar nga: Sarah S.
Përkthyer nga: Arianit Iljazi
Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

BFC
PO Box 3
Winnipeg, MB R3C 2G1
Canada


©2012 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.

Kur Jezusi jetoi në tokë, Ai u tregoi dishepujve të Tij rreth Parajsës. Ai e quajti atë "Shtëpia e Atit Tim", dhe tha se ka shumë banesa të mëdha atje. Banesë është një shtëpi shumë e madhe dhe e bukur. Parajsa është më e madhe dhe më e bukur se çdo shtëpi tokësore.



Jezusi tha: "Unë po shkoj të përgatis një vend për ju. Dhe nëse Unë shkoj të përgatis një vend për ju, unë do të vi sërish dhe do t'ju marr pranë Meje". Pasi u ringjall prej së vdekurish, Jezusi shkoi në Parajsë. Ndërsa dishepujt e Tij po vështronin, Jezusi u ngrit lart në një re që e largoi nga sytë e tyre.



3

Që prej asaj kohe të Krishterët kujtojnë që Jezusi u premtoi, se do të vijë sërish për ti marrë.

Jezusi tha se do të vijë papritmas, kur më së shumti nuk e presin. Por çfarë do të ndodhë me të Krishterët që vdesin përpara se Ai të vijë? Bibla na tregon se ata shkojnë menjëherë për të qenë me Jezusin.




Të mos jesh më në trup, do të thotë të jesh në praninë e Zotit.

4


Zbulesa, libri i fundit në Biblël, na tregon sa e mrekullueshme është Parajsja. Dhe gjëja më e mrekullueshme është se, në një mënyrë shumë

të veçantë, Parajsja është shtëpia e Perëndisë. Perëndia është i gjithkundodhshëm, por Parajsja është froni i Tij.



5

Engjëjt dhe qeniet e tjera qiellore e adhurojnë Perëndinë në qiell. Po kështu bëjnë edhe njerëzit e Perëndisë që patën vdekur dhe kanë shkuar në Parajsë. Ata i këndojnë këngë shumë të veçanta Perëndisë.



6


Këtu janë disa fjalë të një prej këngëve që ata këndojnë: TI JE I DENJË SEPSE TI NA KE SHPENGUAR ME GJAKUN TËND TEK PERËNDIA, JASHTË NGA ÇDO FIS, POPULL, GJUHË KOMB DHE NA KE BËRË MBRETËR DHE PRIFTËRINJ PËR PERËNDINË TONË. (Zbu 5:9)



7

Faqet e fundit të Biblës e përshkruajnë Parajsën si "Jerusalemi i Ri". Ky qytet është shumë shumë i madh, i rrethuar me një mur të lartë nga jashtë. Muri është nga diaspër, i qartë si kristali. Xhevahiret dhe gurët e çmuar në themelet e murit, shkëlqejnë

me ngjyra mahnitëse. Secila nga dyert e qytetit është bërë nga një perlë e vetme e stërmadhe.



8


Ato dyer të mëdha prej perlash nuk mbyllen kurrë. Le të shkojmë brenda dhe ti hedhim një sy rreth e qark... UAU! Parajsa qenka edhe më e bukur nga brenda. Qyteti është i bërë nga ar i pastër, si xham i tejdukshëm.

Madje dhe rrugët janë prej ari të kulluar.




9

Një lumë i bukur e i pastër, rrjedh nga froni i Perëndisë me ujin e jetës. Në të dy anët e lumit shtrihet pema e jetës, që gjendej fillimisht në Kopshtin e Edenit. Ajo nxjerr dymbëdhjetë lloje të ndryshme frytash, një lloj të ndryshëm për çdo muaj. Dhe gjethet e pemës së jetës janë për shërimin e kombeve.




10

Parajsa nuk ka nevojë për diell ose hënë për dritë. Vetë lavdia e Perëndisë e mbush atë me dritë të mrekullueshme. Nuk ka asnjëherë natë atje.




11

Madje edhe kafshët në Parajsë janë ndryshe. Janë të gjitha të zbutura dhe miqësore. Ujq'rit dhe qengjat ushqehen me bar, së bashku. Madje edhe luanët e fuqishëm hanë kashtë si kau. Zoti thotë: "Ata nuk do të dëmtojnë, as nuk do të shkatërrojnë mbi malin Tim të shenjtë".



12

Ndërsa ne shikojmë rreth e qark, janë disa gjëra që nuk i gjejmë në Parajsë. Fjalë zemërimi nuk dëgjohen kurrë atje. Askush nuk fillon një zënkë ose tregohet vet'dashës.



Nuk ka kyçe nëpër dyer, sepse nuk ka hajdutë në Parajsë; as gënjeshtarë, as vrasës, as shortarë, as ndonjë lloj tjetër njerëzish të ligj.

13

Në Parajsë me Perëndinë, nuk ka më lot. Disa herë njerëzit e Perëndisë qajnë për shkak të dhembjeve të mëdha në këtë jetë. Në Parajsë Perëndia do të fshijë tutje të gjitha lotët.



14

Nuk ka as vdekje në Parajsë; njerëzit e Perëndisë do të jenë përgjithmonë me Zotin. Nuk ka më dhembje, as të qara, as trishtim. As sëmundje, as ndarje, as varrime.


Çdokush në Parajsë është i lumtur me Perëndinë.



15


Më e mira e të mirave është se Parajsa është për çuna dhe goca (por edhe për të rriturit) që besojnë dhe i binden JEZUS Krishtit si Shpëtimtar dhe Zot të tyre. Në parajsë është një libër që quhet, Libri i Jetës së Qengjit. Është plot me emra njerëzish. A e dini ju se emrat e cilëve janë shkruar atje?

Emrat e të gjithë njerëzve që besojnë në Jezusin. A është edhe emri yt atje?



16

Fjalët e fundit të Biblës rreth Parajsës, janë një ftesë e mrekullueshme. "Dhe Fryma dhe Nusja thonë, 'Eja!' Dhe le të thotë kush dëgjon 'Eja!' dhe kushdo ka etje le të vijë. Dhe kush dëshiron, le të marrë ujin e jetës falas."



17

Parajsa, Shtëpia e Bukur e Perëndisë

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Gjonit 14; 2 Korinthisve 5;
Zbulesa 4, 21, 22

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."
Psalmet 119:130

18

Fund

60



60

19

Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkatet. Dënimi për mëkatet është vdekja, por Perëndia ju do juve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të jetojë në ty, dhe ti do të jetojë me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu: Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem, eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo, të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

20